

COVID 19. REFLEKTIME

Rigen Lushaj

Master i Shkencave, Studime politike dhe strategjitë ekonomike të zhvillimit, UMSH



Në ditët e para të këtij virusi që shumë shpejt do të merrte përmasat e pandemisë në nivel global, fillimisht qëndrova indiferent sepse mendoja që po ndodhte në një vend tepër larg meje, dhe për me tepër mendoja se bota ka njohur dhe do të njohë gjithmonë sëmundje infektive.

Me përshkallëzimin e situatës dhe përhapjes masive mendimi i parë ishte se çfarë do të ndodhë kur të mbërrijë në vendin tonë. Shikoja sesi njerëzit e vendeve që po e përjetonin menjëherë “aktivizuan” instiktin e vetmbrojtjes duke dyndur dhe boshatisur raftet e supermarketeve. Shikoja sesi shtetet po rrëzonin një nga një ato vlerat dhe solidaritetin që vet i promovonin.

Arrita gjithashtu të shoh më mirë mjerimin e disa njerëzve që fatkeqësisht ishin lënë në harresë, dhe që ky virus e nxorri në pah. Thirrjet për “distancim social” më solli ndërmend që ky distancim social në një formë apo në një tjetër kishte ndodhur dhe para kësaj pandemie, por tashmë ishte kamufluar me distancimin fizik. Jeta pothuajse na ka ndryshuar këto javë duke praktikuar një stil jetese që fillimisht u gjykua si i papërshtatshëm filluam të bëjmë mësim online, të punojmë online, por dhe një liri të kufizuar. Fillova të mendoj akoma më shumë se ne jetojmë në bazë të asaj që na ofrohet. Përshkallëzimi i kësaj situatë mendoj se mund të ishte shmangur po të mos ekzistonte egoizmi dhe arroganca e një pakice njerëzish që janë në pushtet dhe që po na ofrojnë këtë stil jetese prej javësh, ndërsa ne e pranojmë me përulësi nga frika. Kuptova që liria jonë nuk u kufizua tani, thjesht u përforcua më shumë.

Në këto ditë karantine po kuptojmë sesa pak e kemi marrë si të mirëqënë komunitetin, dhe sesa shumë kemi abuzuar. Erdhi kjo sëmundje, dhe pavarësisht nëse je miliardë, pronar i kompanive të mëdha, njeri me pushtet, apo “shërbëtor” i shërbimeve financiare, po na trajton të gjithëve të barabartë. Erdhi një sëmundje dhe na tregoi sesa e cmuar dhe e pasigurtë është jeta jonë.

Ky virus po sillet si prindi jonë që na dënonte të kuptonim gabimet. Shpresoj që cdo gjë të shikohet me një prizëm tjetër, dhe sa më shpejt të heqim distancimin fizik për të kontribuar që të ndërtojmë një shoqëri ku të jetojmë një jetë sociale.